

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQERISE TREGTARE
"BRAIN Lab 3D" SH.P.K TIRANË

Neni 1

Në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar, me vullnetin e tij të lirë, ortakët e shoqërisë kanë rënë dakord të hartojnë këtë akt themelimi dhe statut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) "**BRAIN Lab 3D** " **Sh.p.k** Tiranë, e cila do të veprojë sipas legjislacionit në fuqi e themeluar nga ortakët e saj si vijon:

1. **Individi z. Xhuljano Muça**, me shtetësi Shqiptare dhe kombësi Shqiptare, lindur me **20/10/1995** në **Elbasan, Shqipëri**, me banim në Shqipëri , në adresën: **Nd.13, Hyrja 22, Rr. Musa Agolli**, Tiranë, Shqipëri, e identifikuar me kartë identiteti shqiptare me nr. ID **J51020014R** me datë skadence 27/02/2034, madhor dhe me aftësi të plotë juridike për të vepruar ligjërisht.
2. **Individi znj. Alba Merdani**, me shtetësi Shqiptare dhe kombësi Shqiptare, lindur me **17/07/1995** në **Elbasan, Shqipëri**, me banim në Shqipëri , në adresën: **Nd.13, Hyrja 22, Rr. Musa Agolli**, Tiranë, Shqipëri, e identifikuar me kartë identiteti shqiptare me nr. ID **J55717090J** me datë skadence 12/02/2023, madhor dhe me aftësi të plotë juridike për të vepruar ligjërisht.

Deklaron se, sot, më datë 06/03/2025, ka nënshkruar këtë akt themelimi dhe këtë statut dhe ka rënë dakord për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në bazë të këtij akt themelimi dhe statuti duke respektuar kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

Neni 2

EMËRTIMI, FORMA DHE SELIA E SHOQËRISË

- 2.1. Emërtimi i shoqërisë tregtare të themeluar nga ortakët e saj do të jetë "**BRAIN Lab 3D**" **Sh.p.k**.
Forma e shoqërisë tregtare të themeluar do të jetë **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k)**.
- 2.2. Selia e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Njësinë nr. 8, Nd.13, Hyrja 22, Rr. Musa Agolli, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

3.1. Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të jetë si vijon:

1. Tregtia dhe zhvillimi i produkteve inovative:
 - a. Import, eksport, prodhim, zhvillim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i modeleve mekanike, puzzle-ve 3D, produkteve edukative dhe argëtuese inxhinierike.
 - b. Zhvillimi dhe prodhimi i produkteve të bazuara në teknologjinë STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Art dhe Matematikë).
 - c. Dizajn, zhvillim dhe prodhim i produkteve mekanike dhe elektroteknike, si dhe tregtimi i pajisjeve inteligjente dhe të automatizuara.
2. Tregtia online dhe e-commerce:
 - a. Krijimi dhe menaxhimi i një platforme online për shitjen e produkteve inovative.
 - b. Zhvillimi dhe administrimi i faqeve e-commerce për shitjen me pakicë dhe shumicë të produkteve fizike dhe dixhitale.
 - c. Ofrimi i shërbimeve të personalizuar për klientët nëpërmjet porosive të veçanta dhe shitjes online.
 - d. Shitja përmes marketplace-ve ndërkombëtare si Amazon, eBay, Etsy, Alibaba, si dhe përmes rrjeteve sociale dhe platformave dixhitale.
3. Shitja dhe distribucioni në pika fizike:
 - a. Hapja dhe menaxhimi i dyqaneve fizike për shitjen e produkteve edukative, teknologjike dhe mekanike.
 - b. Krijimi i rrjeteve të shitjes dhe distribucionit për bashkëpunim me dyqane të tjera dhe furnizues.
 - c. Ofrimi i shërbimeve të specializuara për dyqane dhe kompani të interesuara për produkte inovative dhe edukative.
4. Importi, eksporti dhe shpërndarja ndërkombëtare
 - a. Importi dhe eksporti i produkteve nga dhe në tregjet ndërkombëtare.
 - b. Krijimi i partneriteteve me furnizues dhe distributorë në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.
 - c. Shërbime logjistike dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit për optimizimin e shpërndarjes së produkteve.
5. Marketingu dhe promovimi i produkteve:
 - a. Krijimi i fushatave të marketingut dixhital për promovimin e produkteve online dhe në dyqanet fizike.
 - b. Shërbime reklamimi, sponsorizimi dhe promovimi përmes platformave sociale, Google Ads dhe kanaleve të tjera dixhitale.
 - c. Organizimi i eventeve promocionale dhe demonstrimeve për prezantimin e produkteve të reja në treg.
6. Shërbime mbështetëse për klientët dhe bizneset:
 - a. Konsulencë për zgjedhjen dhe përdorimin e produkteve për klientët dhe bizneset.
 - b. Shërbim pas shitjes, përfshirë garanci dhe asistencë teknike për produktet e shitura.
 - c. Menaxhimi i ankesave dhe mbështetje për përmirësimin e përvojës së blerjes për klientët.
7. Organizimi i aktiviteteve edukative dhe zhvillimi profesional:
 - a. Sigurimi i shërbimeve të modelimit organizativ për evente, kurse trajnimi, internship-e,

konferenca dhe çertifikime në sektorë të ndryshëm.

- b. Organizimi i trajnimeve dhe workshop-eve për fëmijë dhe të rritur mbi teknologjinë STEAM, mekanikën dhe robotikën.
- c. Bashkëpunime me institucione akademike dhe kërkimore për zhvillimin e produkteve të reja.
- d. Aplikimi në projekte dhe organizata ndërkombëtare për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të biznesit.

3.2. Aktivitetet për të cilat kërkohet paraprakisht një leje, licencë, autorizim apo ndonjë akt tjetër miratues, do të ushtrohen pasi të jetë marrë akti në fjalë.

Neni 4
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është **pa limit**.

Si ditë e fillimit të aktivitetit të saj do të merret data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

Neni 5
KAPITALI I THEMIELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 lekë, i cili përbëhet nga kontributi vetëm në para. Ky kapital, i cili përbëhet nga 2 (dy) pjesë (kuotë) është nënshkruar nga ortakët e saj themelues dhe vlera nominale e dy pjesëve (kuote) është 100,000 lekë. Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë do të jetë si vijon:

- **Ortaku, individ i znj. Xhuljano Muça** do të zotërojë 50 % të kapitalit të shoqërisë e barabartë me 1 (një) kuotë dhe vlera nominale e një pjesë (kuote) do të jetë 50,000 lekë.
- **Ortaku, individ i znj. Alba Merdani** do të zotërojë 50 % të kapitalit të shoqërisë e barabartë me 1 (një) kuotë dhe vlera nominale e një pjesë (kuote) do të jetë 50,000 lekë.

Neni 6
KONTRIBUTET

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ofrojë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë me marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

Neni 7

KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë, këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kutotave.

Shoqëria tretare mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

Nëse personat që zotërojnë një kuotë nuk arrijnë një marrëveshje, atëherë zbatohen dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë.

Neni 8

MËNYRA E FITIMIT DHE E KALIMIT TË KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata.

Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshirë këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

Ne rast kalimi të kuotave për persona të tretë që janë jashtë shoqërisë, ortakët që shet kuotat duhet të njoftojë me shkrim shoqërinë dhe duhet të ofrojnë të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo ortakëve të tjerë të shoqërisë.

Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit sipas paragrafit të mësipërm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë. Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit ortakët brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi duhet të blejnë apo të lejojnë blerjen e kuotave të kapitalit themeltar me vlerën kontabile të kapitaleve të veta që do të rezultojë sipas bilancit kontabël në datën e shitjes së kuotave.

Neni 9

PASOJAT E KALIMIT TË KUOTAVE

Personi që kalon kuoten dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Neni 10

PJESËTIMI I KUOTAVE DHE TRANSFERIMI I TYRE

Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre. Dispozitat e nenit 73 të ligjit "Për shoqëritë tregtare" për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.

Neni 11

SHPERNDARJA E FITIMEVE

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Ortakët e shoqërisë që aprovojnë shpërndarjen e fitimeve (dividendit) mund të ndryshojnë shpërndarjen e fitimeve nga sa është parashikuar në statut vetëm nëse miratohet me unanimitet të plotë të ortakëve duke e kaluar atë për zmadhim kapitali dhe për investime në shoqëri.

Neni 12

KUFIZIMET E SHPËRNDARJEVE, ÇERTIFIKATA E AFTËSISË PAGUESE

1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas nenit 13, të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes shoqërise dhe ortakut, e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.
4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

ADMINISTRATORI

Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

Administrator i shoqërisë "**BRAIN Lab 3D**" sh.p.k Tiranë emërohet:

z. Xhuljano Muça dhe afati i emërimit është për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje.

1. Emërimi i administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

"Emërimi i administratorit, i cili hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u drejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nuk mund të emërohen si admistratore të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

c) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërise, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

g) shitblerjen, kontributet dhe dhënien me qira të ndërmarrjeve ose degëve të ndërmarrjes;

gj) themelimin e shoqërive të çdo lloji, konsorciumeve dhe enteve kolektive t çdo lloji;

i) shitjen dhe blerjen e pjesëmarrjeve dhe interesave të çdo lloji;

j) blerjen, shitjen dhe dhënien me qira të pasurive të paluajtshme të regjistruara;

4. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim.

SHPËRBLIMI PËR ADMINISTRATORIN

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të

ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 14

PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

Neni 15

REGJISTRIMI I SHPËRBËRJES

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" të ndryshuar.

Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykatë, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit " ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim.

Neni 16

MOSMARRËVESHJET

Për çdo mosmarrëveshje ndërmjet ortakëve, e lindur në kuadrin ose për shkak të kësaj kontrate, do të bëhen të gjitha përpjekjet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, çështja i paraqitet Gjykatës së Tiranës, duke u gjykuar mbi bazën e ligjislacionit shqiptar.

Neni 17

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Për gjithçka që nuk është shprehur në statutin e kësaj shoqërie, do t'u referohemi ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

Ky statut u shkrua, u lexua dhe u firmos me vullnet të lirë e ndergjegje të plotë nga ortakët themelues të shoqërisë "**BRAIN Lab 3D** "Sh.p.k ,Tiranë, sot më datë 06.03.2025, në tre kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT E SHOQËRISË
"BRAIN Lab 3D" SH.P.K, TIRANË

XHULJANO MUÇA

ALBA MERDANI

